

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6825
E martë, 14 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Të premten mbahet
seanca solemne për nder
të 15-vjetorit të pavarësisë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË KUVENDIN E KOSOVËS ËSHTË MBAJTUR DEBAT PARLAMENTAR PËR ZHVILLIMET
NË KUADËR TË DIALOGUT NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

OPOZITA THOTË SE DIALOGU KA HYRË NË RRUGËN QË NUK ÇON DREJT MARRËVESHJES FINALE



Kryeministri Albin Kurti ka raportuar sot para deputetëve lidhur me dialogun Kosovë - Serbi. Opozita ka pasur një varg kritikash për të. Debatit parlamentar lidhur me dialogun është iniciuar nga Partia

Demokratike e Kosovës (PDK), e cila në kërkesën e shkruar ka thënë se në dy vitet e fundit dialogu ka hyrë në rrugën që nuk çon drejt marrëveshjes finale. Kurti ka bërë me dije se më 20 janar emisari i Gjermanisë, i

Francës, i Italisë, i ShBA-së dhe i BE-së i dorëzuan planin përfundimtar të propozimit evropian. "Ata ma bënë të qartë që propozimi kryesor këtë herë është fare pranë formatit 'merre ose lëre'", ka treguar Kurti

KOSOVËS I SHTOHEN EDHE 433 POLICË TË RINJ

FAQE 7



KOSOVA DHE SHQIPËRIA DUHET T'I SHFRYTËZOJNË EDHE MË TUTJE RAPORTET E BASHKËPUNIMIT



FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

GËRHXHALIU: ËNDËRROJ QË ME KOSOVËN TË LUAJ NË EVROPIAN

F. 10



SPORT

RIZVANOLLI SQARON SITUATËN NË TREPÇË: JANË RRRITUR PRODHIMI DHE TË HYRAT, JANË ULUR SHPENZIMET

F. 8



SHPËTOHEN DISA PERSONA NË TURQI, NUMRI I VIKTIMAVE ARRIN MBI 37 000

F. 3



AKTUALE

SHTËPIA E BARDHË: ASNJË BALONË AMERIKANE NUK KA FLUTURUAR MBI KINË

F. 2

PËRKUJTOHET DËSHMORI AVNI HAJREDINI NË 23-VJETORIN E RËNIES

F. 6

EKONOMI

NËNSHKRUHEN MARRËVESHJET NË VLERË 1.2 MILION EURO PËR MBËSHTETJEN E 19 KUZHINAVE POPULLORE

F. 8



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Shtëpia e Bardhë: Asnjë balonë amerikane nuk ka fluturuar mbi Kinë

WASHINGTON, 13 SHKURT - Shtëpia e Bardhë mohoi të hënën akuzën e Pekinit se Shtetet e Bashkuara kanë dërguar balona mbi Kinë për të kryer mbikëqyrje, teksa tensionet rreth pajisjeve të spiunazhit po rriten mes dy superfuqive. "Çdo pretendim se qeveria amerikane operon me balona vëzhgimi është i pavërtetë" shkruan zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë në "Twitter", duke shtuar se është Republika Popullore e Kinës "që ka një program të balonave të mbikëqyrjes për mbledhjen e inteligjencës".

Kina më herët gjatë ditës tha se më shumë se 10 balona amerikane kanë fluturuar mbi hapësirën e saj të lartë ajrore gjatë vitit të kaluar, pa lejen e saj, pas akuzës së Uashingtonit se Pekini po operon një flotë balonash vëzhgimi në mbarë botën.

Pretendimi kinez vjen pasi ShBA-ja rrëzoi një balonë të dyshuar spiune kineze që kishte kaluar nga Alaska në Karolinën e Jugut, duke ndezur një krizë të re në marrëdhëniet dypalëshe që kanë arritur në nivelin më të ulët në dekada.

Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze Wang Wenbin nuk dha detaje në lidhje me balonat e supozuara të ShBA-së. "Është gjithashtu e zakonshme që balonat amerikane të hyjnë ilegalisht në hapësirën ajrore të vendeve të tjera", tha Wang në një konferencë të përditshme. "Që nga viti i kaluar balonat e ShBA-së në lartësi të mëdha kanë

fluturuar ilegalisht mbi hapësirën ajrore të Kinës më shumë se 10 herë pa miratimin e autoriteteve kineze", shtoi ai.

Wang tha se ShBA-ja duhet "së pari të reflektojë për veten dhe të ndryshojë mënyrën e diskutimit në vend që të njollosë dhe të nxisë një konfrontim".

Kina thotë se balona e rrëzuar nga ShBA-ja ishte një aeroplan pa pilot i krijuar për kërkime meteorologjike që ishte zhvendosur nga kursi për shkak të erërave të forta. Ajo ka akuzuar ShBA-në për reagim të tepruar duke e rrëzuar atë dhe kërcënoi se do të ndërmarrë veprime, por nuk saktësoi se cilat janë ato.

Pas incidentit, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, shtyu vizitën e planifikuar për Pekin, që ishte paraparë të ndodhte disa ditë pasi u zbulua balona e parë. Ky do të ishte udhëtimi i parë i një kryediplomati amerikan në Kinë për shumë vjet.

Gjithashtu të hënën, Filipinet po ruajnë komunikimin përmes kanaleve diplomatike në këtë drejtim", tha Wang. Duke shtuar tensionet, të dielën, një avion luftarak ushtarak amerikan shkatërroi një objekt të pidentifikuar mbi liqenin Huron me urdhër të presidentit Joe Biden.

Ky shënoi incidentin e katërt të tillë në harkun kohor të tetë ditëve dhe është vazhdimësi e serisë së veprimeve ushtarake mbi hapësirën ajrore amerikane. Balona kineze e rrëzuar nga ShBA-ja ishte e pajisur për të



përmajtje". "Kina dhe Filipinet po ruajnë komunikimin përmes kanaleve diplomatike në këtë drejtim", tha Wang.

Duke shtuar tensionet, të dielën, një avion luftarak ushtarak amerikan shkatërroi një objekt të pidentifikuar mbi liqenin Huron me urdhër të presidentit Joe Biden.

Ky shënoi incidentin e katërt të tillë në harkun kohor të tetë ditëve dhe është vazhdimësi e serisë së veprimeve ushtarake mbi hapësirën ajrore amerikane. Balona kineze e rrëzuar nga ShBA-ja ishte e pajisur për të

zbuluar dhe mbledhur sinjale të inteligjencës, si pjesë e një programi të madh të mbikëqyrjes ajrore të lidhur me ushtrinë që synonte më shumë se 40 vende, deklaroi administrata Biden të enjten, duke cituar imazhe nga aeroplanët spiunë amerikanë të tipit U-2.

Që atëherë Shtetet e Bashkuara kanë vendosur kufizime ekonomike për gjashtë entitete kineze, për të cilat thuhet se janë të lidhura me programet e hapësirës ajrore të Pekinit, si pjesë e përgjigjes së saj ndaj incidentit.

Dhoma e Përfaqësuesve e ShBA-së gjithashtu votoi unanimisht për ta dënuar Kinën për një "shkelje të pacipë" të sovranitetit të ShBA-së dhe përpjekjet për ta "mashtuar komunitetin ndërkombëtar përmes pretendimeve të rreme për fushatat e saj të mbledhjes së inteligjencës".

Wang, zëdhënësi kinez, hodhi poshtë pretendimet e tilla nga ana e Kinës, duke thënë se "shqitja e shpeshtë e raketave të avancuara nga ShBA-ja për t'i rrëzuar objektet është një reagim i tepruar dhe i mbisforcuar".

Arabia Saudite do ta dërgojë gruan e parë në hapësirë



RIAD, 13 SHKURT - Arabia Saudite do ta dërgojë gruan e parë astronute në hapësirë, në një mision më vonë gjatë këtij viti, raportoi media shtetërore. Ky vendim po shihet si



një përpjekje për ta përmirësuar imazhin ultra-konservator të kësaj mbretërie.

Rayyana Barnawi do t'i bashkohet astronautit saudit Ali Al-Qarni në

misionin në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës "gjatë çerekut të dytë të vitit 2023", raportoi agjencia "Saudi Press".

Astronautët "do t'i bashkohen

ekipit të misionit të hapësirës AX-2" dhe nisja e tyre do të bëhet "nga Shtetet e Bashkuara", tha agjencia.

Ky shtet do t'i ndjekë hapat e

fqinjtit të tij, Emirateve të Bashkuara Arabe, që më 2019 u bë shteti i parë arab që dërgoi qytetarë në hapësirë.

Atëbotë astronauti Hazzaa al-Mansoori qëndroi për tetë ditë në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës. Edhe një shtetas i Emirateve, Sultan al-Neyadi, po ashtu do të udhëtojë drejt hapësirës më vonë gjatë këtij muaji.

Lideri de-fakto i Arabisë Saudite, Princi i Kurorës, Mohammed bin Salman, ka tentuar që ta përmirësojë imazhin e mbretërisë, duke shtyrë përpara reforma.

Që kur erdhi në pushtet më 2017, gratë janë lejuar që të vozisin dhe të udhëtojnë jashtë vendit pa u shoqëruar nga burrat. Po ashtu, pjesëmarrja e tyre në tregun e punës është dyfishuar, nga 17 në 37 për qind.

Shpëtohen disa persona në Turqi, numri i viktimave arrin mbi 37 000

ANKARA, 13 SHKURT - Ekipet e kërkim-shpëtimit në Turqi kanë nxjerrë të gjallë nga rrënojat e ndërtesave të shembura disa persona. Teksa shpresat për të gjetur të mbijetuar të tjerë po veniten, numri i përgjithshëm i viktimave nga tërmetet në Turqi dhe Siri, të hënën arriti në mbi 37 000 dhe pritet që ky numër të rritet. Faza e shpëtimit "është drejt fundit" dhe tani pritet që përpjekjet të përqendrohen në ofrimin e strehimit dhe ushqimit për të mbijetuarit, tha shefi për ndihmë i Kombeve të Bashkuara, Martin Griffiths, gjatë vizitës në Alepo të Sirisë më 13 shkurt. Këto deklarata të tij erdhën në kohën kur ekipet në Turqi arritën të nxjerrin të gjallë nga rrënojat disa persona. Zyrtarët thanë se një vajzë e vogël, e quajtur Miray, u shpëtua në Adijaman pas 178 orësh nën rrënoja. Në po të njëjtin qytet u shpëtua edhe një grua 35 vjeçe. Një grua e quajtur Naide Umay u nxor e gjallë nga rrënojat e ndërtesave në Antakija dhe në po të njëjtin vend u shpëtuan edhe dy fëmijë. Ndërkaq, në provincën Gaziantep, shpëtimtarët nxorën të gjallë nga rrënojat një grua. Më herët u bë e ditur se ekipet e shpëtimit nga Takhikistani kanë nxjerrë të gjallë një djalë trevjeçar nga rrënojat, në qytetin turk të Kahramanmarash. Ai kishte kaluar 158 orë aty, njoftoi shërbimi i shtypit i Komitetit për Situatat Emergjente dhe Mbrojtjen Civile të



Takhikistanit më 13 shkurt. Takhikistani dërgoi një grup prej 50 shpëtimtarësh dhe mjekësh, si dhe 2.5 tonë pajisje speciale në Turqi, për të ndihmuar vendin në përballjen me pasojat e tërmetit të 6 shkurtit. Kombet e Bashkuara, një ditë më parë, dënuan dështimin për të ndihmuar rajonet e Sirisë, teksa paralajmëruan se

numri i viktimave nga tërmetet në Turqi dhe Siri, që ka arritur në mbi 37 000, mund të dyfishohet. Autoritetet konfirmuan të hënën se janë konfirmuar mbi 37 000 viktima në Siri dhe Turqi. Numri më i madh i viktimave është në Turqi, përkatësisht 31 643 dhe në Siri janë regjistruar 5 714. Dhjetëra mijëra punëtorë të shpëtimit po

vazhdojnë operacionet për të gjetur të mbijetuar pavarësisht prej temperaturave të ulëta që kanë rënduar gjendjen e miliona personave që tani kanë nevojë për ndihmë. OKB-ja ka paralajmëruar se të paktën 870 000 persona kanë nevojë urgjente për shujta të ngrohta në mbarë Turqinë dhe

Sirinë. Vetëm në Siri, deri në 5.3 milionë persona mund të mbesin të pastrehë. Tërmeti prej 7.8 ballësh që u pasua nga disa tërmete të tjera të fuqishme – në Turqi dhe Siri, është fatkeqësia e shtatë më vdekjeprurëse e këtij shekulli. Një tërmet me magnitudë të ngjashme në Turqi më 1999 kishte vrarë mbi 17 000 persona.

Kosova dhe Shqipëria duhet t'i shfrytëzojnë edhe më tutje raportet e bashkëpunimit



PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të hënën në takim një delegacion parlamentar nga Shqipëria, i përbërë nga anëtarë të Komisionit për Integrim Evropian. Në takim u diskutua për marrëdhëniet e shkëlqyera që parlamentet e të dyja vendeve kanë ndërtuar midis tyre, ndërsa u vlerësua se mbi këtë bazë mund të avancohen më tej ato në të gjitha nivelet e bashkëpunimit. Kreu i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se Kosova dhe Shqipëria duhet t'i shfrytëzojnë hapësirat për t'i zhvilluar më tutje raportet e bashkëpunimit dhe bashkëpunimit konkret në të gjitha fushat, kur tashmë ekzistojnë një sërë marrëveshesh

midis dy qeverive. Kryetari Konjufca falënderoi deputetët e Kuvendit të Shqipërisë për angazhimin e tyre në mbështetje të Kosovës në të gjitha forumet dhe organizatat ndërkombëtare si në afirmimin e subjektivitetit ndërkombëtar, ashtu edhe në atë të procesit të integritimit evropian. Duke shprehur kënaqësinë që gjendet për vizitë në Kosovë dhe në Kuvendin e saj, kryetarja e Komisionit për Integrim Evropian të Kuvendit të Shqipërisë, Jorida Tabaku dhe anëtarë të tjerë të delegacionit, vlerësuan lart frytet e bashkëpunimit të deritashëm midis dy vendeve, duke shtruar nevojën që këtij bashkëpunimi t'i jepen impulse të reja konform rrethanave dhe mundësive të krijuara.

Të premtën mbahet seanca solemne për nder të 15-vjetorit të pavarësisë

PRISHTINË, 13 SHKURT - Të enjten, më 16 shkurt 2023, në orën 10:00, Kuvendi do ta mbajë seancën plenare të radhës, ndërsa një ditë më pas, më 17 shkurt, do të mbahet seancë solemne, në shënim të 15-vjetorit të pavarësisë së

Kosovës. Kështu vendosi Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur të hënën të drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca. Në seancën e të enjtes, pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi do të

votojë për propozimin e GP të Vetëvendosjes për zëvendësimin e anëtarëve nëpër komisione parlamentare, për të vijuar me votimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në rend dite të kësaj seance do të jetë edhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për verëra dhe shqyrtimi i Projekt-rezolutës për adresimin e çështjes së rritjes së faturave të tatimit në pronë.





NË KUVENDIN E KOSOVËS ËSHTË MBAJTUR DEBAT PARLAMENTAR PËR ZHVILLIMET NË KUADËR TË DIALOGUT NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Opozita thotë se dialogu ka hyrë në rrugën që nuk çon drejt marrëveshjes finale

Kryeministri Albin Kurti ka raportuar sot para deputetëve lidhur me dialogun Kosovë - Serbi. Opozita ka pasur një varg kritikash për të. Debatit parlamentar lidhur me dialogun është iniciuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila në kërkesën e shkruar ka thënë se në dy vitet e fundit dialogu ka hyrë në rrugën që nuk çon drejt marrëveshjes finale. Kurti ka bërë me dije se më 20 janar emisari i Gjermanisë, i Francës, i Italisë, i ShBA-së dhe i BE-së i dorëzuan planin përfundimtar të propozimit evropian. “Ata ma bënë të qartë që propozimi kryesor këtë herë është fare pranë formatit ‘merre ose lëre’”, ka treguar Kurti

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të enjten debat parlamentar për zhvillimet në kuadër të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Debatit parlamentar lidhur me dialogun është iniciuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila në kërkesën e shkruar ka thënë se në dy vitet e fundit dialogu ka hyrë në rrugën që nuk çon drejt marrëveshjes finale.

“Çka është qëllimi i propozimit evropian? A ofron ky propozim mundësinë e marrëveshjes finale? A është ky vazhdim i dialogut apo pikënisje e re? A ka kornizë kohore ky dialog?”, këto ishin disa nga pyetjet e kryetarit të PDK-së, Memli Krasniqi, drejtuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Krasniqi shtroi dhe pyetje të tjera që kryesisht lidheshin me propozimin evropian. “Cili është teksti i fundit dhe përmbajtja zyrtare e këtij propozimi dhe a e parasheh

njohjen e ndërsjellë mes dy vendeve i njëjti? Si dhe, a parashihet vazhdimi i dialogut edhe pas marrëveshjes?”, pyeti ai.

Kurti ka thënë se Qeveria e Kosovës e ka ndërtuar qasjen e saj strategjike përballë dialogut me Serbinë, mbi bazën e dy qëllimeve fillestare. Qëllimi i parë, siç tha ai, është ndërprerja e praktikës së përfshirjes së çdo çështjeje potencialisht kontestuese ndërmjet palëve në fushëveprimin e dialogut. Ndërkaq, qëllimi i dytë, sipas tij, është hapja e kapitullit të një procesi të bisedimeve për ndërtimin e raporteve të jashtme të fqinjësisë së mirë dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare si dy shtete të pavarura që e bazojnë marrëdhënien e tyre mbi premisën e njohjes së dyanshme të shtetësisë.

Kurti tha se më 9 shtator ka marrë propozimin e njohur si franko-gjerman nga i dërguari i Francës, Emmanuel Bonne, dhe nga i dërguari i Gjermanisë, Jens Plotner, në praninë e të dërguarit të posaçëm të BE-së

për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. “Ata prezantuan para meje një propozim për normalizimin e ndërmjetëm të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të bazuar në parimin e njohjes de facto dhe mbështetjen e saj në parimet e kartës së Kombeve të Bashkuara dhe parimet e qarta të së drejtës ndërkombëtare”, ka deklaruar Kurti.

Ai shtoi se, edhe pse i ishte kërkuar nga emisarët që konfidencialiteti i dokumentit të respektohet, ai i kishte ftuar kryetarët e tri partive opozitare për t'i njoftuar ata me përmbajtjen e propozimit. Kryeministri Kurti më tej shpjegoi se mbi çfarë bazash ishte dokumenti i propozuar nga dy emisarët, gjerman dhe francez. “Propozimi bazohet në modelin e marrëveshjes gjermano-gjermane të vitit 1972 dhe të shumë modeleve të tjera të ngjashme të njohjeve de facto të shtetësisë në historinë e marrëdhënieve ndërshtetërore si për shembull: marrëveshja Japoni-Kore Jugore”, është

shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se propozimi ngërthente në vete pranimin nga palët të parimit të barazimit në sistemin ndërkombëtar, i cili është parimi kyç i kartës së Kombeve të Bashkuara për sa iu përket marrëdhënieve ndërmjet shteteve të pavarura. Kurti ka thënë se Qeveria e Kosovës e komentoi versionin e parë të propozimit dhe kërkoi “avancimin të tij drejt një marrëveshjeje finale me njohjen de jure në qendër të saj”. Kryeministri Kurti ka thënë se në parim pikat e propozimit janë bazë e mirë për diskutim. Por, sipas tij, “e vetmja pikë shumë kontestuese është ajo që lidhet me pranimin e zbatimit të marrëveshjeve të kaluara të Brukselit, shumica nga të cilat, fatkeqësisht, janë marrëveshje që kanë në përmbajtje elementin monoetnik, atë territorial dhe atë të monopolizimit të përfaqësimit të komunitetit serb në duart e Listës Serbe që kontrollohet nga Beogradi”.

Kurti tha se më 6 dhjetor Lajçaku i kishte ofruar një version të dytë

të propozimit, në të cilin ishin përfshirë vërejtjet e palës së Kosovës, por pa lëvizur prapa nga parimet që ngërthente propozimi i parë. “Dokumenti shoqërohej me një plan zbatimi, që kishte referencë të qartë të një statut që do ta hartonte ekipi menaxhues, obligim që rrjedh nga marrëveshja [e Brukselit] e vitit 2013, gjë që është një tregues i një hapi të një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe”, ka thënë ai. Kurti tha se më 20 janar të vitit 2023, emisari i Gjermanisë, i Francës, i Italisë, i ShBA-së dhe i BE-së i dorëzuan planin përfundimtar të propozimit evropian. “Ata ma bënë të qartë që propozimi kryesor këtë herë është fare pranë formatit ‘merre ose lëre’. Nuk do të lejohet, praktikisht, hapja apo negociimi i tij... Ata gjithashtu ma bënë të qartë se çfarëdo refuzimi i propozimit, do të shoqërohet me hapa kundërshtues dhe ndëshkues diplomatik për Kosovën”, ka theksuar Kurti. Ai shtoi se, megjithatë, kishte shtuar vërejtjet dhe kërkesat e tij se “propozimi duhet të përfshijë më shumë elementë garantues dhe siguresa të efektivitetit sa i përket anëtarësisimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, shtimit të numrit të njohjeve dhe një sequencim të ngjarjeve,

në formë të tillë që të ketë kuptim normalizimi ndërmjet dy shteteve”. Sipas Kurtit, këto kërkesa ishin sqaruar më 6 shkurt, në takimin me Lajçakun në Prishtinë dhe më pas atij ia kishte konfirmuar që propozimi i BE-së “është bazë e mirë për bisedime të mëtejme dhe platformë solide për të ecur përpara”. “Plani kryesor nuk ka asnjë referencë të një asociacioni, megjithëse u referohet marrëveshjeve të Brukselit në tërësinë e tyre. Tash, hapi kryesor, ku do të lindin pyetjet më serioze në ndërlidhje me Asociacionin, do të jetë në procesin e negociimit të planit të zbatimit”, ka deklaruar Kurti. Ai shtoi se qëndrimi i tij është që çështja e Asociacionit mund të merret në konsideratë “nëse plotësohen gjashtë kushtet, parimet”.

Kurti rreth një javë më parë kishte paraqitur gjashtë kushte për ta shqyrtuar mundësinë e formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, tha se Kurti është kundërthënë në ato që thotë. “Në njërin anë thotë që ka një draft të dytë, që tha se është dokument merre ose leje, por njëkohësisht e ka pranuar si bazë të mirë. Tani nuk mund të pranosh si bazë të mirë diçka që është merre ose leje.

Ose është bazë përfundimtare, ose është bazë fillestare”, ka thënë ai.

Ai ka shtuar se një tjetër kundërthënie është që Kurti, sipas tij, flet që ka rend dhe ligj në katër komunitet në veri të Kosovës, por në anën tjetër kërkon “çarmentosjen e veriut dhe dorëzim të armëve”.

Më 2 shkurt Kurti kishte vendosur gjashtë kushte për themelimin e Asociacionit. Mes të tjerash, që “strukturat ilegale të Serbisë në veri shuhet dhe bëhet dorëzimi i të gjitha armëve ilegale”. Abdixhiku tha se shpërputhja më e madhe dhe logjike e Kurtit është “mes refuzimit që provon t’ia bëjë themelimit të Asociacionit dhe pranimit brenda draftit të marrëveshjeve paraprake”. “Pra, respektimi i marrëveshjeve paraprake është pranim i Asociacionit”, tha ai.

Ai tha se Kurti ka dy rrugë përpara: zhbërjen e Marrëveshjes së Asociacionit, ose implementimin e saj sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese.

ShBA-ja dhe BE-ja kanë rritur presionin ndaj Kosovës që t’i zbatojë marrëveshjet e arritura për Asociacionin më 2013 dhe 2015.

Uashingtoni ka deklaruar se nuk do të mbështesë asnjë asociacion që do t’i ngjasonte një

Republika Sërpska, siç është në Bosnjë e Hercegovinë.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 2015 tha se disa pika të marrëveshjes nuk ishin në harmoni me Kushtetutën, por që mund të harmonizohen.

Në këtë debat parlamentar për propozimin evropian, Ramush Haradinaj, kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, tha se kanë premtim nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që me nënshkrimin e marrëveshjes, Kosova do të ndihmohet në anëtarësim në NATO. “Do të përkrahemi për partneritet për paqe dhe për rrugëtimin tonë drejt NATO-s”, tha ai që, sipas tij, është arsyeja kryesore pse propozimi evropian, i njohur edhe si plani franko-gjerman, përkrahët nga partia e tij. Propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi u është dorëzuar dy vendeve në fund të verës së vitit të kaluar, por përmbajtja e tij nuk është bërë publike.

Në dokument nuk përmendet njohja e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë apo anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara - për të cilat gjëra insistojnë publikisht zyrtarët kosovarë - por theksohet mbështetja që palët duhet t’i japin njëra-tjetrës në procesin e integritimeve evropiane.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, kërkoi nga Kurti që të vendosë një kusht shtesë, i cili, sipas tij, do të ishte një lloj garancie që do të mundësonte zbatimin e marrëveshjes me Serbinë.

“Kërko nga aleatët, pra ndërmjetësuesit, që Republika e Serbisë ta regjistrojë këtë marrëveshje, nëse arrihet, në kuadër të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara. Pra, Karta e OKB-së e ka ndërtuar një mekanizëm pas Luftës së Dytë Botërore, që marrëveshjet që arrihen nga shtetet anëtare të OKB-së mund të regjistrohen në sekretariat... Ne s’jemi anëtar, por nëse ata [Serbia] do ta regjistronin [këtë marrëveshje], ky do të jetë një mekanizëm që ne do që mund ta përdornim dhe ta kontestojm atë në kuadër të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në rast se Serbia nuk do ta respektonte këtë marrëveshje”, tha ai.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka nisur në vitin 2011, fillimisht për çështje teknike, për të evoluuar një vit më pas në dialog politik. Aktualisht, të dyja palët janë duke e shqyrtuar propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që më herët njihet si plani franko-gjerman.





Përkujtohet dëshmori Avni Hajredini në 23-vjetorin e rënies

MITROVICË, 13 SHKURT - Me rastin e 23-vjetorit të rënies së dëshmorit Avni Hajredini, kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, i shoqëruar nga nënkryetari Arian Tahiri, drejtorë të drejtorive komunale, familjarë, drejtues të shoqatave të luftës dhe banorë të Lagjes së Boshnjakëve, sot kanë vënë kurora me lule pranë pllakës

përkujtimore të dëshmorit në veri të Mitrovicës dhe te varrezat e dëshmorëve në Shipol. Kryetari Hamza ka vlerësuar lart kontributin e dëshmorit Avni Hajredini për çështjen kombëtare dhe për çlirimin e vendit e të Mitrovicës, duke thënë se kontributi i tij për të mirën e kombit e të atdheut dhe sidomos për të mirën e Mitrovicës na bënë të gjithëve

të ndihemi krenarë.

Dëshmori Hajredini ishte vranë më 13 shkurt të vitit 2000 në "Lagjen e Boshnjakëve", në veri të qytetit të Mitrovicës, kur po kalonte nëpër lumin për të dalë në veri në mbrojtje të shqiptarëve që ishin sulmuar barbarisht nga bandat kriminale serbe duke ushtruar terror të vërtetë mbi ta dhe po ndiqeshin nga shtëpitë e tyre.

Totaj dhe ambasadori i Italisë diskutojnë për bashkëpunim në fushën e kulturës e të turizmit

PRIZREN, 13 SHKURT - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Antonello De Riu dhe drejtorin e Institutit Italian të Kulturës në Tiranë, Alessandro Ruggera, me ç'rast rikonfirmuan miqësinë me

shtetin italian si dhe diskutuan për fuqizimin e bashkëpunimit në fushën e kulturës e të turizmit. Gjatë këtij takimi ambasadori De Riu propozoi binjakëzimin e Prizrenit me njërin nga qytetet e Italisë për shkëmbimin e përvojave e të qytetarëve tanë.



Kurti e pret ambasadorin francez: Kosova mbetet e përkushtuar dhe konstruktive në dialog



PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mirëpritur të hënën ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot. Marrëdhëniet bilaterale shumë të mira ndërmyet dy vendeve dhe mënyrat për avancimin e mëtejshëm të tyre, dhe propozimi evropian për normalizim të raporteve me Serbinë, i përkrahur edhe nga Franca, ishin temat qendrore të bisedës. "Republika e Kosovës mbetet e

përkushtuar dhe konstruktive në dialog teksa dëshiron marrëdhënie të mira fqinjësore dhe integrim në BE dhe NATO", u shpreh kryeministri Kurti. Ai e falënderoi ambasadorin Guerot për rolin dhe mbështetjen e vazhdueshme të Francës ndaj Kosovës si në zhvillimin e brendshëm ashtu edhe në fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar përmes anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Mbahet takimi i parë periodik me drejtorët e shkollave të Rahovecit për vitin 2023

RAHOVEC, 13 SHKURT - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Avni Morina dhe zyrtarë komunalë nga kjo drejtori, kanë mbajtur takim me drejtorë të shkollave fillore të mesme të ulëta dhe të larta të komunës së Rahovecit. Në

këtë takim është diskutuar lidhur me mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor. Në fjalën e tij drejtori i Arsimit, Avni Morina, tha që sapo kemi filluar gjysmëvjetorin e dytë të mësimit dhe jemi në prag të festës së 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe me këtë rast janë

parapë të zhvillohen një varg aktivitete të kulturës dhe sportive. Këto aktivitete do të fillojnë nga data 11 shkurt, andaj ju ftojmë të gjithëve të angazhoheni dhe të merrni pjesë në këto aktivitete. Ndërsa kryetari Latifi ka kërkuar nga të gjithë drejtorët që në koordinim të plotë me personelin arsimor, të angazhohen maksimalisht që të vazhdojnë në mënyrë të rregullt mbajtja e procesit mësimor dhe të respektohet rendi shtëpiak në shkolla. I pranishëm në këtë takim ishte edhe komandanti i Stacionit të Policisë në Rahovec, Fazli Morina, i cili raportoi për gjendjen e sigurisë në shkolla dhe ofroi bashkëpunim ndërinstytucional për ta rritur nivelin e sigurisë, sidomos në shkollat e mesme të larta.



Pas kërkesës së banorëve, rinovohet shkolla e fshatit Tërdec në Drenas

DRENAS, 13 SHKURT - Komuna e Drenasit ka filluar nëpërmjet dëgjimeve buxhetore në secilën bashkësi lokale ta bëjë identifikimin e nevojave të qytetarëve në këtë komunë.

Nëpërmjet dëgjimeve buxhetore nëpër bashkësitë lokale janë përzgjedhur prioritetet ku do të zhvillohen projekte kapitale për qytetarët e kësaj komune. Një e tillë është edhe në shkollën

e fshatit Tërdec, ku është bërë ndërhyrja në renovimin e klasave të kësaj shkolle. "Falënderojmë qytetarin Ramadan Ramaj për publikimin e gjendjes së klasave para dhe

pas ndërhyrjeve në renovim të tyre. Mbetemi të përkushtuar të punojmë shumë, ta rregullojmë mirëqenien e gjithë qytetarëve tanë", ka njoftuar komuna e Drenasit.



Diplomon gjenerata e 57 e Policisë së Kosovës

Kosovës i shtohen edhe 433 policë

433 kadetë u betuan të hënën si pjesëtarë të rinj të Policisë së Kosovës. Në ceremoninë e diplomimit morën pjesë edhe përfaqësuesit e institucioneve të vendit, të cilët theksuan se kjo ditë është krenari për shtetin e Kosovës

EPOKA
ERE

MAL QORRAJ

PRISHTINË, 13 SHKURT - Të hënën kanë diplomuar 433 kadetë të rinj të gjeneratës së 57 të Policisë së Kosovës, në mesin e tyre edhe 53 gra. Presidentja Vjosa Osmani, e cila ishte e pranishme në këtë ceremoni, ka deklaruar se këta kadetë janë ata që garantojnë siguri dhe mjedis të sigurt për të gjithë qytetarët pa dallim. "Ju duhet të jeni qytetarë modelë të Republikës së Kosovës", ka thënë Osmani. Presidentja ka shtuar se në mesin e të diplomuarve janë 17 serbë, 5 boshnjakë, 2 goranë, një turk dhe një rom. "E në mesin e këtyre kadetëve janë 53 vajza e gra të guximshme e të përkushtuara për t'i shërbyer vendit të tyre. Kjo pjesëmarrje e grave në polici reflekton angazhimin e përbashkët e serioz që të rritet numri i pjesëmarrjes së grave në polici. Është koha që gratë të jenë në krye të detyrave e funksioneve më të larta", ka thënë Osmani. Ajo ka shtuar se kadetët duhet të jenë krenarë me uniformën që kanë veshur. "Kam besimin e fuqishëm që do t'u qaseni



detyrave tuaja me seriozitet", tha Osmani. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka shtuar se për qeverinë tonë, mbrojtja dhe siguria e vendit dhe vendosja e rendit dhe ligjit janë prioritet. "Policia qëndron e palëkundur në misionin e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike", ka thënë Kurti, duke shtuar se jemi të lumtur që policia renditet ndër tri institucionet më të besueshme për qytetarët. Kurti ka theksuar se policët kanë treguar se nuk bëjnë kompromis me bandat dhe krimin. "Kolegët tuaj me

angazhimin e tyre kanë treguar se nuk bëjnë kompromis me bandat edhe krimin. Janë sulmuar, janë plagosur por nuk janë dorëzuar, përkundër kësaj ata janë akoma aty në krye të detyrës", ka thënë Kurti. Kryeministri u është drejtuar kadetëve të cilët diplomuan që t'i qëndrojnë besnik betimit të tyre dhe vendit. "Kujtojmë kolegët tuaj që nuk u dorëzuan përballë asgjëje duke zbatuar misionin e përbashkët. Rënia e tyre në mbështetje të sovranitetit tonë shtetëror, e kundër krimin e paligjshmërisë,

mbetet shembull i dashurisë së pakushte për republikën tonë", u shpreh Kurti, duke thënë se institucionet do t'u ofrojnë mbështetje. Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, ka thënë se sot është një ditë krenarie. "Keni zgjedhur t'i shërbeni atdheut tonë të përbashkët dhe qytetarëve të saj. 433 vajza e djem të ri po i bashkohen policisë, institucionit kyç të shtetit tonë, për mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të vendit e luftimit të pakompromis të krimin e korrupsionit", ka thënë Sveçla. Ministri ka shtuar se ky

profesion kërkon zotim për të shërbyer me ndershmëri. "Po i bashkoheni policisë në kohën më të nevojshme për vendin. Jam besimplotë se do të jeni nderi dhe krenaria e brezave dhe gjeneratave që do t'ju pasojnë", ka deklaruar Sveçla. Sveçla pati edhe një kërkesë për kadetët e rinj: "Çdo ditë kur vishni uniformën, kujtojeni betimin që do ta jepni sot. Mbani në mend se askush nuk është mbi të drejtën dhe se ligji është për ta mbrojtur qytetarin. Duhet të jeni në zbatim të ligjit çdo ditë", ka theksuar ministri Sveçla.

Nënshkruhen marrëveshjet në vlerë 1.2 milion euro për mbështetjen e 19 kuzhinave popullore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 SHKURT - Në vazhden e angazhimeve të Qeverisë së Kosovës për ngritjen e mirëqenies sociale në vend, Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për të tretën herë radhazi po mbështet financiarisht organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime të kuzhinave popullore. Ky aktivitet realizohet në kuadër të masës 3.4 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe parasheh mbështetjen e 19 organizatave humanitare me 1.2 milion euro të cilat do të ofrojnë shujta falas për familjet që kanë nevojë.



Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjeve, kryeministri Albin Kurti tha se "kuzhinat popullore, përveçse ofrojnë shujta për ata më në

nevojë, janë gjithashtu simbol i humanizmit tonë të përbashkët dhe dëshmi e fuqisë së komunitetit për të ndikuar pozitivisht në jetën e atyre, të cilët kanë më së shumti nevojë". Ndërkaq ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, në anën tjetër vlerësoi lart bashkëpunimin e deritanishëm me organizatat humanitare, duke thënë se "masa 3.4 fillimisht është pilotuar për të parë nëse organizatat humanitare kanë nevojë për mbështetje nga shteti, dhe si rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm që kemi pasur deri më tani, jemi të lumtur që edhe këtë vit po vazhdojmë që përmes jush ta zgjasim dorën e shtetit te familjet që kanë më shumë nevojë". Deri më tani organizatat përfituese nga ky lloj i mbështetjes kanë ofruar mbi

300 mijë shujta ushqimore, ndërkaq në pranverë të vitit të kaluar, në kuadër të po të njëjtës masë, Ministria e Financave, përmes 39 organizatave joqeveritare partnere, financoi blerjen e afro 35 mijë pakove ushqimore, të cilat organizatat i shpërndanë te familjet më në nevojë në të gjitha komunat e vendit tonë. Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për ndërmarrjen e politikave që kanë për synim mbështetjen e familjes, ngritjen e mirëqenies dhe qasjen më të lehtë në shërbime sociale për të gjithë qytetarët. Qytetarët që kanë nevojë për mbështetje duhet të drejtohen tek organizatat humanitare në komunën e tyre.

Rizvanolli sqaron situatën në Trepçë: Janë rritur prodhimi dhe të hyrat, janë ulur shpen-

PRISHTINË, 13 SHKURT - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, përmes një reagimi publik të hënën ka sqaruar situatën në Trepçë, në Minierën e Stantërgut. Në një postim në "Facebook", Rizvanolli ka thënë se po qarkullojnë shumë të pavërteta, ndaj ka sqaruar se në këtë ndërmarrje publike është parë përparim gjatë dy vjetëve të fundit. "Me a pa qëllim, po qarkullojnë shumë të pavërteta në lidhje me situatën në Trepçë, në minierën e Stantërgut. Kjo është vërteta: Më 27.01.2023 pas mesnatës ka pasur prishje të kabllos së energjisë elektrike në mes horizonteve 5 e 7 të minierës, kablo kjo 70 vjet e vjetër. Është reaguar menjëherë, qysh në 03:45 me rastin e ndodhjes së aksidentit. Menaxhmenti ka reaguar menjëherë duke rivendosur kablo të re prej 180m, brenda disa orësh pas prishjes, si dhe duke instaluar sistemin e pompimit për largimin e ujërave nga miniera. Me këto ndërhyrje dhe punën e vazhdueshme të punonjësve aty, niveli i ujit po ulet. Mirëpo derisa uji të largohet plotësisht xehet nuk mund të barten për në flotacion", ka thënë ajo.

Rizvanolli ka theksuar se ndërkohë menaxhmenti është duke marrë masa shtesë për të vendosur kablo alternative në tërë gjatësinë e kabllos nga horizonti 1 deri në horizontin 11, me gjatësi prej 1000m. "Të thuhet se faktor është keqmenaxhimi apo mospuna është jo vetëm gënjeshtër, por edhe ofendim për të gjithë ata minatorë, teknikë, inxhinierë e

udhëheqës të tyre që po punojnë ditë e natë për ta sanuar situatën, e të cilëve u jemi pafundësisht falënderues. Të thuhet se sfidat e Trepçës janë indikatorë se ajo duhet privatizuar është prapë jo vetëm e pabazuar, por edhe ofenduese për inteligjencën e punonjësve të Trepçës e të gjithë qytetarëve të Mitrovicës e të Republikës së Kosovës", është shprehur ministria Rizvanolli, duke shtuar se në Trepçë kanë hyrë më se 100 milionë euro të taksapaguesve që nga paslufta por, çuditërisht, nuk ka pasur asnjë investim serioz që nga viti 2008. "Një pjesë e madhe e tyre me gjasë, thjesht, u avulluan. Mbetjet e vlefshme u shitën për vlera qesharake e në mënyrë të jashtëligjshme. Tokat e Trepçës u dhanë me qira për eksploitim nga operatorët privatë. Dhjetëra prona të paluajtshme të Trepçës u lejuan të uzurpohen me dekada nga operatorë të ndryshëm. Trepça nuk kishte rregullore të punës, rregullore për menaxhim të pronës, e pothuajse për asgjë tjetër, sepse kështu ishte në interes të atyre që e kanë vjedhur e zhvatur Trepçën pamëshirshëm e në mënyrë të paskrupullt ndër vite", është shprehur ajo.

Rizvanolli ka thënë se Trepça nuk u auditua nga Zyra e Kombëtare e Auditimit që nga viti 2012 derisa, sipas saj, kryeministri Albin Kurti nuk kërkoi auditim të saj në vitin 2021 dhe ky auditim i performancës u realizua. "Ndërkohë, Njësia e Auditimit të Brendshëm në ndërmarrje ishte degraduar për vite të tëra për të



pamundësuar evidentimin dhe parandalimin e keqpërdorimeve. Trepça nuk ka problem me pronësi - publike apo private. Trepça është vjedhur e zhvatur ndoshta më shumë se çdo ndërmarrje tjetër publike, edhe pse kjo nuk ka qenë aq e dukshme sa tek disa të tjera, sepse ata që e kanë (keq)menaxhuar janë kujdesur që as dokumentim e auditim si duhet të mos ketë", ka theksuar ministria.

Ajo ka thënë se ky kapitull është mbyllur njëherë e përgjithmonë me qeverisjen tonë. "Si çdo institucion e ndërmarrje tjetër publike, jam e bindur që Trepça e ka kaluar tashmë periudhën e saj të errët dhe ajo ka një të ardhme të ndritshme. Siç kemi thënë që nga fillimi i mandatit,

qeveria jonë është e përkushtuar për t'i përkrahur ndërmarrjet publike në rrugën e tyre të ligjshmërisë e ringjalljes, por që kjo përkrahje kushtëzohet nga përkushtimi i tyre për ta eliminuar krimin e korrupsionin përbrenda e për ta rritur performancën", ka deklaruar Rizvanolli.

Ajo ka thënë se gjatë këtyre dy vjetëve kanë parë këtë përparim te Trepça. "Janë rritur prodhimi e të hyrat e janë ulur shpenzimet operative. Janë miratuar një varg rregullore që vendosin rend e disiplinë. Ne si qeveri e kemi përkrahur Trepçën me subvencione për t'u përballur me krizën energjetike dhe me investime kapitale. Mirëpo ende kemi shumë punë përpara bashkë e do t'i rrimë në

krah Trepçës në rrugëtimin e saj. Tani është koha ta përkrahim Trepçën edhe me investime në teknologji të re - investime këto që nuk janë bërë që 50 vjet e që do ta rritin efikasitetin e prodhimit, performancën operative e financiare të ndërmarrjes, e do të mundësojnë hapjen e vendeve të reja të punës", ka thënë ajo, duke shtuar se: "Pavarësisht që disave u janë prishur llogaritë e interesat, e kjo frymë e re mund të mos u pëlqejë, Trepça dhe ndërmarrjet e tjera publike do të bëhen e po bëhen, në funksion të qytetarëve e të shtetit të Kosovës, e në të mirë të punonjësve të tyre që punojnë palodhshëm e me nder!".

Zbuten qëndrimet e naftëtarëve, nis zbatimi i vendimit për marzhën e fitimit

PRISHTINË, 13 SHKURT - Naftëtarët në vend po e respektojnë vendimin e fundit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për marzhën e fitimit përkundër që Shoqata e Naftëtarëve ka shprehur pakënaqësi me këtë vendim.

Mirëpo, kryetari i kësaj shoqate, Fadil Berjani, ka bërë me dije se janë zbutur qëndrimet e naftëtarëve të cilët në mbledhjen e fundit ishin të tensionuar dhe kishin kërkuar protesta e mbyllje të pikave të karburanteve. Megjithatë, Berjani paralajmëron se këtë vendim do ta dërgojnë në gjykatën përkatëse për shqyrtim pasi që, sipas tij, është i kundërligjshëm. I pyetur për abuzimet me çmime nga kompanitë, Berjani tha se nuk ka informacione, por shtoi se me këtë punë duhet të merren inspektorati dhe organet kompetente. "Vendimi është duke u respektuar dhe është i

plotfuqishëm. Por, në mbledhjen e kuvendit të shoqatës tonë situata ka qenë e tensionuar. Anëtarët kanë kërkuar të protestohet dhe mbyllin pikat e shitjes së karburanteve. Mirëpo, kemi dalë nga ajo situatë dhe kemi vendosur që t'i drejtohem gjykatës për vendimin e ministrisë. Ne iu kemi drejtuar me një letër kërkesë ministres. Sot presim të na kthejë përgjigje. Megjithatë, si ta kemi përgjigjen nga ajo (ministria Rozeta Hajdari), ne do t'i drejtohem gjykatës sepse vendimi i cili është nxjerrë është në kundërshtim me ligjin", ka theksuar ai.

Me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së konkurrencës dhe për t'i mënjanuar çrregullimet në treg, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ditë më parë ka marrë vendim për caktimin e



çmimit dhe masave të tjera mbrojtëse të produkteve të naftës. Sipas këtij vendimi, marzha tregtare maksimale e

lejuar e shitjes me shumicë është 2 euro për litër, kurse marzha tregtare maksimale e lejuar e shitjes me pakicë është 12 euro

për litër. Berjani ka treguar se të hënën çmimet e derivateve kanë qenë 1.37 euro për naftë dhe 1.34 euro për benzinë./KP/

Kishat ortodokse shqiptare dhe uzurpimi i tyre nga shteti serb (1)

(Sllavizimi i kishave shqiptaro-bizantine të Kosovës, projekte të hershme të Serbisë)



Shkruan: Faton B. MEHMETAJ

Falsifikimet e Akademisë së Shkencave të Serbisë në formë sistematike që i përdorin elitat e inteligjencës serbe të formuluar si "argumente historike" të krijuara nga qendrat pansllave, shërbejnë si dëshmi për të treguar "të drejtën historike" dhe ta shtrojnë rrugën për arsyetimin e politikës së tyre ekspansioniste, presektimin e vazhdueshëm në kohë paqeje, duke e përdorur kurdoherë gjenocidin dhe spastrimin etnik në kohën e luftërave në dem të shqiptarëve, të cilët përfaqësojnë "muzën e gjallë" të kulturës botërore. Nga ky invazion serbosllav i inteligjencës serbo-ruse që ka filluar ta dominoi Ballkanin Perëndimor me theks të veçantë janë sulmuar kisha të rritit ortodoks bizantin shqiptar të cilat element serb përvetësoi si të tilla, edhe pse serbët në përgjithësi nuk kanë një kulturë të tyre origjinale e aq pak histori, sepse dihet kush është populli autokton dhe më i vjetri i Gadishullit Ilirik (shqiptarët) dhe kush është i ardhur (serbët). Nuk dua të kthehem prapa në histori, por për të treguar kush janë serbët duhet parë gjatë dy shekujve të fundit gjenocidin që e kanë bërë mbi popullin shqiptar, debimet masive për ta shpopulluar popullatën vendase dhe në vend të tyre e vendosën popullatën serbo-sllave.

Vazhdimisht si popull i egër që ishte një pjesë e popullatës, me theks të veçantë nga periudha e Dushanit i konvertojnë ritin ortodoks sllav duke përfshirë këtu edhe elementin ortodoks shqiptar dhe kuptohet edhe atë të krishterë. Ky konvertim që bëhej ndaj popullit shqiptar me qëllime asimiluese zgjatë nga ajo kohë deri në vitin 1989 kur Slobodan Millosheviqit erdhi në Gazimestan për ta shënuar 600 vjetorin e Betejës së Kosovës e që edhe ky është një fakt tjetër që tregon se serbët nuk kanë histori të vetën në Kosovë, prandaj i festojnë betejat e të tjerëve si të tyre për ta përvetësuar historinë me argumentin e forcës. Serbët ishin në aleancë me turqit. Madje për tu dukur shumë në atë tubim pjesa dërmuese e serbëve pjesëmarrës u sollën nga Serbia me dhunë sepse në Kosovë elementi minoritar duke përfshirë këtu edhe serbët ishin tejet pak, më pa se 0,1 për qind. Për ta bërë historinë e tyre dhe më

minore, ata ndërtuan në atë kohë disa kisha në pjesë të ndryshme të Kosovës, e në mesin e tyre ndërtuan edhe atë në hapësirat e Bibliotekës Kombëtare në Prishtinë, kisha këto të cilat kurrë nuk u funksionalizuan sepse ishin pa identitet, nuk ishin kisha por makete politike.

Liderët serb për ta mbajtur popullin më afër Kosovës sajuan disa slogane krejt false si: "Jetën e japim Kosovën se japim" apo "Kosova është Serbi" e ngjashëm parulla këto që i nxitën shumë njerëz për të ardhur në Kosovë në luftën e fundit për të bërë gjenocid dhe spastrim etnik. Edhe përkundër kësaj barbarie të makinerisë ushtarake serbe nuk u arrit asgjë, sepse populli serb ishte pushtues dhe nuk ishte në vendin e vet.

Për këtë arsye Slobodan Millosheviq si president i Serbisë brenda Jugosllavisë nga viti 1989-1997, por edhe si president i Republikës Federale të Jugosllavisë nga viti 1997 deri në vitin 2000, i cili njihet edhe si kasapi i Ballkanit, më 28 qershor 2001 u ekstradua në Hagë, i akuzuar për krime lufte dhe gjenocid në Kosovë, Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë. Ai u bë kreu i parë në detyrë i shtetit që u akuzua për krime lufte. Edhe pse i ndihmuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë për të gjitha të bëmat në ish-Jugosllavi me qëllim të formimit të Serbisë së Madhe ashtu siç parashihet edhe në librin "Memorandumi për Kosovë e Metohi" i botuar nga kisha ortodokse serbe, Millosheviqit së bashku me Akademikët dhe Kishën Ortodokse e humbën betejën. Kjo tregon se lufta e Akademisë serbe për ta përvetësuar një pjesë të historisë sonë ishte e gjatë, por e pasuksesshme. Tendencat pushtuese ishin rishfaqur pas vitit 1878 edhe në vitin 1912, kur Serbia me fuqi të madhe ushtarake, e armatim modern rus të kohës, e okupoi Kosovën përkohësisht. Tendencat tjetër e okupimit të Kosovës nga Serbia u bëmë 8-10 korrik 1945 në Kuvendin e Prizrenit. Ky kuvend duhet theksuar se nuk ishte as i pari e as i fundit, i cili solli vendime që Kosova të aneksohej nga Serbia e Jugosllavia. Duhet cekur se aneksimi nga kjo njësi federale kishte filluar qysh më herët, ndërsa nga ky Kuvend pushtetarët jugosllavë kërkonin formalisht vetëm një "verdict të popullit". Tendencat e Serbisë për ta okupuar Kosovën vazhduan edhe më 23 Mars 1989, kur Serbia me trysinë e tankeve të ushtrisë jugosllave dhe terrorin e tejskajshëm të policisë, suprimoi autonominë e Kosovës të garantuar me Kushtetutën e vitit 1974 me të cilën shqiptarët kishin fituar statusin më të lartë politik e juridik deri atëherë në kuadër të federatës jugosllave. Për ta kamufluar këtë

terror ndaj popullsisë së qetë shqiptare, qeveria e Beogradit deklaronte se kjo është vetëm "reformë agrare", "aksion", "aksion kundër komitëve dhe armiqve të shtetit" etj. Në emër të kësaj, Kosova u kolonizua, u dogj, u grabit, shkatërruar dhe u tjetërsua çdo gjë që e argumentonte të kaluarën tonë dhe lashtësinë e autoktonisë në Gadishullin Ilirik që tash së voni quhet Ballkanik. Serbia në asnjë kohë nuk ka mundur ta gjë madje asnjë dokument që e dokumenton autoktoninë e vet në këto troje. I vetmi dokument i tyre ka qenë gënjeshtra dhe dezinformimi, për mes të cilit kanë mbijetuar deri më sot. Kjo armë e egër e Serbisë ka funksionuar deri vonë për shkak se Serbia nuk i lejonte shqiptarët që t'i hapnin shkollat e tyre. Për shkak të këtyre rrethanave serbët krijuan lehtësisht mitet e tyre të rrejshme. Ata, këto mite të historisë i shfrytëzuan për mashtrim, dezinformim, nënshtrim dhe shkatërrim të vlerave tradicionale të popullit shqiptar. Shumë kohë shkrime mbi historinë tonë të lavdishme u shkruan, jo nga ne, por sipas dëshirës së sundimtarëve-pushtuesve.

Prandaj dezinformimi historikisht u bë vegël në shërbim të aspiratave të kishës ortodokse serbe dhe Akademisë së Arteve të Serbisë. Këta "akademik" shpikën në studimet e tyre duke blerë edhe studiues të haj, për ta forcuar idenë e tyre mbi historiografinë e Kosovës që ka të bëjë me originalitetin e kishave ortodokse shqiptare, duke mohuar ndërtuesit e tyre bizantin dhe origjinën autoktone të këtyre kishave, për ti arsyetuar uzurpuesit e këtyre kishave që ishin serbët. Këta gjatë gjithë historisë lidhën

aleanca të forta me rusët dhe turqit për ti dëmtuar shqiptarët. Bashkëpunimi sllavo-otoman zgjati një kohë të gjatë, në fillim si vasal dhe aleat, sa edhe gjatë shek. 16-të kur Mehmet Pasha Sokoloviçi emëroi vëllanë e tij, Makarie Sokolloviqin për patrik dhe rivendosi selinë në vitin 1557. Kjo që lëshuar gjatë kryengritjes shqiptare nënë udhëheqjen e Pjetër Bogdanit kundër otomanëve, kur Patriku Arsenije Çernojeviç u shpërngul së bashku me shqiptarët në veri në vitin 1690. Ata lansuan teza të llojllojshme në shtypin ndërkombëtar dhe vendorë kundër shqiptarëve duke mbështetur në paragjykimet dhe duke përdorur epitete të natyrave jo etike siç janë: "Shqiptarët e egër", "pushtuesit shqiptar", "terroristët shqiptarë", etj. Me kalimin e kohës "akademiket" shpikën tezen se Kosova është Jerusalem i Serbisë edhe pse në Kosovë nëntëdhjetë për qind e 2.2 milionë të popullatës së Kosovës janë shqiptarë etnik (qysh nga koha parahistorike). Akademikët serb kishin zgjedhë më të mirin prej tyre Radivoje Papoviçin, një kolonist serb nga Hercegovina (student me nota më të ulëta, pa magistraturë fitoj titullin doktor, alkoolist i madh dhe shkencëtar sharlatan, biolog që u bë rektor i Universitetit serb të Prishtinës në vitin 1991 vetëm pse i shante dhe fyente shqiptarët publikisht duke e shpërfaqur pa kurrfarë rezerve gjuhën e urrejtjes kundër popullit shqiptar. Në këto baza të urrejtjes pansllave kundër shqiptarëve qëndronte edhe "Memorandumi" i Akademisë serbe të shkencave më 1986, i cili në të vërtetë përfaqësoonte një version të sintetizuar të të gjitha Projekteve

të mëparshme për spastrimin etnik (gjenocidin) në Gadishullin e Ilirisë qysh nga shekulli 19-të. Gjatë sundimit të Perandorit Komneni shumë kisha të Kosovës qenë rindërtuar, qëndrojnë edhe në ditët tona duke përfshirë Shinkollin në Pejë (e ashtuquajturat patriakat), Shën Mëria në Prizren, kishë kjo albano-bizantine me dekorimet e saj është më origjinalja mes kishave. Në pjesën kryesore të kishës, në mesin e zbukurimeve më tërheqëse janë dy shqiponja dykrerëshe të ngjyrës së kuqe që mbizotërojnë altarin me madhësinë e tyre në brendësinë rrethore. Kuptohet shqiponja dykrerëshe është simbol pellazgo-ilir dhe bizantino-shqiptar. Pastaj Kisha e Ulpianës afër Prishtinës, Kishën e Damianit. Disa kisha u ndërtuan për të shenjtin e tyre të Kosovës, siç është shenjt i shqiptar Shën Kolli i kohës bizantine (Shin Kolli). Kisha u ngrit mu në rrëzën e Alpeve të larta shqiptare të Dukagjinit pranë Bistricës dhe në hyrje të Grykës së Rugovës.

Festa e këtij shenjt është festuar me shekuj në anë të tona. Kurse në literaturën sllave kisha quhet Patrikana e Pejës, ky emërtim u arrit në kohën e familjes Nemanja. Kishat ortodokse të Kosovës qenë themeluar ndër shqiptarë shumë më herët se ardhja e serbëve, madje mijëra vjet më parë, sepse ata kur erdhën këndeje ishin barbarë. Këtu duhet përmendur kishën ortodokse të Pejës që tradicionalisht është quajtur Shinkolla ose Kollashin d.m.th Shën Nikolla nga shqiptarët (sipas personalitetit udhëheqës të traditës krishtere shqiptare i cili është i varrosur në pjesën jugore të kishës). (Vijon)



Zhujë Veseli, një vojvod shqiptar nga Rugovë, duke ruajtur Patriarkanën e Pejës, Kishën e Shën Kollit

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Gërxhaliu: Ëndërroj që me Kosovën të luaj në Evropian

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, me bashkëpunëtorë, ka pritur në futbollistin e Antalyasporit, Amar Gërxhaliu. Pas tërmetit të fuqishëm në Turqi, kampionati atje është pezulluar përkohësisht, prandaj Gërxhaliu ka shfrytëzuar rastin të vijë për pushime disaditore në vendlindje. Ai aktualisht është pjesë e Përfaqësueses U21 të Kosovës, derisa në të ardhmen pritet të jetë edhe pjesë e Përfaqësueses A, pasi vlerësohet si lojtar me potencial të madh në repartin e mbrojtjes. Presidenti Ademi e përgëzoi Gërxhaliun për paraqitjet e tij të deritashme dhe e inkurajoi të vazhdojë të punojë maksimalisht për ta mbajtur formën dhe për të dëshmuar vlerat e tij, teksa vuri në pah rëndësinë që FFK-ja ua kushton talenteve të reja dhe qëllimin që ka për të afruar sa më shumë

lojtarë të rinj e me perspektivë në Përfaqësuesen A. Nga ana e tij, Gërxhaliu u shpreh mirënjohës për pritjen e ngrohtë dhe theksoi se objektivi i tij është që në të ardhmen të jetë pjesë e Përfaqësueses A të Kosovës. "Jam i lumtur dhe falënderues për takimin që pata me presidentin Ademi dhe me bashkëpunëtorët e tij në FFK. Normalisht që në këtë takim biseduam për paraqitjet e mia me ekipin kombëtar. Jam i lumtur që jam pjesë e Kosovës dhe kam dëshirë të vazhdoj të luaj me fanellën e Kosovës. Aktualisht jam pjesë e ekipit U21, por mezi po pres të luaj sa më shpejt edhe me ekipin A", ka theksuar Gërxhaliu. Ai ka thënë se vendimi për të luajtur për Kosovën nuk ka qenë i ngutshëm. "Si çdo kosovar që është rritur në Kosovë, ashtu edhe unë e kam pas ëndërr të luaj për kombëtaren, prandaj nuk e kam pasur shumë të vështirë të vendos të luaj për

Kosovën", ka shtuar ai. Ai ka folur edhe për paraqitjet e tij në kampionatin turk. "Aktualisht po ndihem shumë mirë me ekipin Antalyaspor dhe tashmë kam filluar të luaj në Superligë, ku në tri ndeshjet e fundit kam pasur minuta shumë, kurse paraprakisht luaja vetëm në ndeshjet e Kupës. Besoj se në ato ndeshje e kam treguar veten dhe e kam bindur trajnerin Sahin se meritoj të luaj edhe në Superligë, më pas ai më dha mundësinë që të jem titullar", është shprehur Gërxhaliu. Ndonëse aktualisht është i lumtur që luan në elitën e futbollit turk, si çdo futbollist tjetër edhe Amari synon që në të ardhmen të jetë pjesë e top ligave evropiane. "Si çdo futbollist që rritet në Kosovë, edhe për mua gjithnjë synimi ka qenë që të luaj në klubet evropiane dhe jam në atë rrugë. Besoj se do të arrij të realizoj atë ëndërr, por patjetër që ëndërr e madhe për mua mbetet edhe të




jem pjesë e ekipit të Kosovës në çdo grumbullim, pse jo që me Kosovën të shkoj edhe në Euro 2024", ka përfunduar Gërxhaliu.

Ai në edicionin 2021/22 ishte pjesë e Vushtrrisë, teksa verën e kaluar u transferua në skuadrën elitare të futbollit turk.

Liga e Kampionëve kthehet me superndeshjen PSG - Bayern

"Epoka e re"

Liga e Kampionëve rikthehet sonte (e martë) me dy ndeshje mjaft interesante në kuadër të 1/8 së finales. Ndeshja kryesore zhvillohet në "Parkun e Princave", ku Paris Saint-Germain e pret Bayern Munchenin. Po të njëjtën ditë luhet edhe takimi mes Milanit dhe Tottenham Hotspurit. Kampionët e Francës shpresojnë që viti 2023 të jetë viti ku ata i japin fund pritjes së gjatë për trofeun e Ligës së Kampionëve, ndërsa kampionët e Gjermanisë ëndërrojnë të kurorëzohen kampionë të Evropës për herë të shtatë. Parisienët kanë një epërsi prej pesë pikësh në krye të tabelës në



FORMACIONET E MUNDSSHME:

Paris Saint-Germain: Donnarumma; Hakimi, Marquinhos, Ramos; Mendes; Pereira; Ruiz, Vitinha, Verratti; Neymar, Messi.
Bayern Munchen: Sommer; Cancelo, De Ligt, Upamecano, Davies; Goretzka, Kimmich; Sane, Musiala, Coman; Choupo-Moting.

TË MARTËN TAKOHEN:
21:00 Paris Saint-Germain - Bayern Munchen
21:00 Milan - Tottenham Hotspur

Ligën 1, por humbja e dy ndeshjeve radhazi nuk është mënyrë ideale për t'u përgatitur për një takim evropian ndaj një skuadre të fortë siç është Bayerni, i cili e mposhti në finalen e sezonit 2020-21. Në anën tjetër gjermanët nuk e nisën mirë sezonin pranveror në Bundesliga ku barazuan në tri ndeshjet e para, por me pas mposhtën Bochumin dhe Wolfsburgun për t'u kthyer në normalitet para ndeshjes së rëndësishme ndaj PSG-së. Lionel Messi e humbi ndeshjen me Monacon, por ai i bashkohet Marco Verratti, i cili, gjithashtu,

rikthehet nga lëndimi. Lajm i mirë për francezët është edhe rikthimi i Kylian Mbappes që mori pjesë në seancën stërvitore të dielën pasi humbi tri ndeshjet e fundit për shkak të një dëmtimi në kofshë. Ndërsa mungesat e kësaj skuadre janë Renato Sanches dhe Nordi Mukiele. Për Bayernin mungojnë Ryan Gravenberch, Noussair Mazraoui, Lucas Hernandez dhe Sadio Mane, kurse Joshua Kimmich do të kthehet nga pezullimi. Lajm i mirë është se edhe veterani Thmoas Muller është i gatshëm për këtë ndeshje. Të martën në "San Siro" do të zhvillohet, po ashtu, një ndeshje mjaft interesante mes kampionit të Italisë, Milanit dhe skuadrës angleze, Tottenham Hotspur.

Rrahmani, 'ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 13 SHKURT - Edhe në sezonin pranveror vazhdon dhënia e çmimit "Ylli i Javës" nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall. Ky çmim për javën e 19 në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Ballkani, Albion Rrahmani. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga

komisioni i veteranëve të futbollit. Sulmuesi i portokallezinjve ka qenë protagonist i kësaj jave, ngase shënoi tre gola në fitoren që skuadra e tij e realizoi si mysafire kundër Malishevës (4-2). Pas marrjes së këtij çmimi, Rrahmani u shpreh i lumtur dhe premtoi se do të vazhdojë me paraqitje të mira edhe në të

ardhmen. "Për mua është hera e parë që shpallëm 'ylli i javës' dhe sinqerisht jam shumë i lumtur. Të shpërblehesh si më i miri i xhiros është një motiv shtesë për ta vazhduar punën dhe për të synuar ende më shumë. Gjithsesi ky çmim nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e bashkëlojtarëve dhe shtabit teknik për çka i falënderoj

shumë", ka theksuar Rrahmani për faqen zyrtare të FFK-së. Ai ka folur edhe për objektivat e portokallezinjve në këtë edicion. "Ballkanin këtë edicion e shoh sërish kampion të Kosovës. Rruga për ta mbrojtur titullin nuk do të jetë e lehtë, por ne do të punojmë maksimalisht dhe do t'i marrim ndeshjet radhazi. Besoj se me këtë grup



të lojtarëve, me përkushtimin e shtabit teknik dhe organizimin e mirë të klubit, do ta përsërisim suksesin e vitit të kaluar", ka shtuar Rrahmani.

Bostoni ruan kreun në Lindje, Toronto fiton në fund

BOSTON, 13 SHKURT - Dy ndeshje të luajtura në NBA. Ekipi i Boston Celticit fitoi me rezultat 119-109 ndaj Memphisit, duke mbrojtur vendin e parë në Konferencën e Lindjes. Një

ndeshje ku kolektiviteti i Bostonit ishte çelësi i fitores, pasi 8 lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Derrick White me 23 pikë e 10 asistime ishte shënuesi më i mirë, duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e Ja

Morantit për miqtë. Fitore në frymën e fundit korri skuadra e Torontos, që mposhti me rezultat 119-118 Detroitin, në një takim me shumë rivalitet dhe emocione, madje dramatik në

fundin e tij. Fred VanVleet me 35 pikë e Pascal Siakam me 28 pikë bënë diferencën në parket për kanadezët, ndërsa 33 pikët e Bojan Bogdanoviç për Detroitin mbetën për statistikë.



Lekndreaj, MVP i javës në Superligë

PRISHTINË, 13 SHKURT - Në javën e 22-të të Prince Caffe Superligës u zhvilluan përballje interesante. Bashkimi shënoi fitore të rëndësishme ndaj Vëllaznimit në Gjakovë. Basketbollisti më i dalluar ishte basketbollisti shqiptar Daniel Lekndreaj me dyshifror të dyfishtë 17 pikë e 15 kërcime, tre asistime, si dhe pesë topa të vjedhur. Ai u ndihmua nga Fisnik Rugova me 11 pikë e 13 kërcime dhe dy asistime. Trepça ka vazhduar me fitore, ku kësaj radhe ka mundur Ponte Prizrenin. Edhe kësaj radhe te mitrovicasit u dallua Drilon Hajrizi me 14 pikë, shtatë kërcime dhe 6 asistime. Golden Eagle Ylli me fitoren ndaj Rahovecit ka dalë në vendin e parë në renditje, ndërsa te therandasit kapiteni Gëzim Morina ishte më i miri me 19 pikë, shtatë kërcime dhe dy asistime. Peja fitoi në klasiken kosovare ndaj Sigal Prishtinës, ku më i miri edhe në këtë sfidë ishte Arti Hajdari. Ai ndaj prishtinasve kishte 14 pikë, tri kërcime dhe tri asistime.



109:45. Fitores së Bashkimit më së shumti i kontribuoi Khadija Brown, e cila shënoi 31 pikë, shtatë kërcime dhe nëntë asistime. Ajo ishte e saktë 10 nga 13 tentimet për dy pikë dhe tri nga shtatë tentimet për tri pikë. Për Bashkimin kontribuoi edhe Aulona Muhadri me 23 pikë, 14 kërcime dhe dy asistime. Muhadri ishte e saktë 10/12 për dy pikë. Për fitoren e Prishtinës ndaj Trepçës


me shifra 67:58 më meritoret ishin Zërina Shatri me 19 pikë, 13 kërcime dhe katër asistime, si dhe Sarah Mgbèike me 16 pikë, 14 kërcime dhe katër asistime. Prishtina është në vendin e dytë në tabelë me 14 fitore dhe tri humbje. Penza fitoi ndaj Vëllaznimit me rezultat 57:39. Më e mira në parket për këtë fitore ishte Saranda Daci me 21 pikë, 19 kërcime dhe dy asistime.

Browni, më e mira e javës në Superligën e femrave

Bashkimi ka regjistruar fitoren e 16 me radhë në Superligën e Femrave, duke triumfuar ndaj United Basketball me shifrat

Legjenda e NBA-s: E kam kritikuar Jordanin dhe ka 10 vjet që s'më flet

Ish-basketbollisti Charles Barkley, një nga ikonat e NBA-së, aktualisht në detyrën e opinionistit pranë TNT, ka folur për marrëdhënien e tij me Michael Jordanin. Ai ka sqaruar se përse marrëdhënia mes tyre ka përfunduar. "Michael ka qenë miku im më i mirë dhe e dua ende fort. Më shqetëson fakti që nuk jemi më miq, por më duhet të jem profesional dhe i drejtë ndaj të gjithëve. Nuk flasim prej 10 vjetësh pasi e kam kritikuar në një intervistë", ka thënë Barkley, që ka luajtur për 16 sezone në NBA dhe është pjesë e "Hall of Fame". "Për të kam thënë se nuk e dija nëse do të kishte sukses si drejtues, pasi rrethohet nga njerëz dhe miq që nuk i thonë kurrë JO. Ai u çmend pasi thashë këtë deklaratë, më mori në



telefon dhe më shau rëndë. Iu përgjigja duke i thënë se duhet të bëj detyrën time dhe që nga ajo

ditë nuk kemi folur më kurrë", ka shtuar Charles Barkley.

SHKURT

Bekim Zogaj do të jetë gjyqtar në ndeshjen Milan - Tottenham

Milani do të përballet sot (e martë) me Tottenhamin në kuadër Ligës së Kampionëve. Ndeshja do të zhvillohet në "San Siro", me fillim nga ora 21:00. Në këtë ndeshje gjyqtar kryesor do të jetë Sandro Scharer, ndërsa asistentë Stephane de Almeida dhe Bekim Zogaj. Loja e parë do të luhet në "San Siro", ajo kthyesë dy javë më pas në Tottenham Hotspur.

KF Llapi transferon Dardan Musliun

Skuadra e Llapit ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me futbollistin Dardan Musliu. Musliu te klubi nga Podujeva ka kaluar nga klubi gjerman FV Lorrach-Brombach. "KF Llapi njofton se ka kompletuar transferimin e mbrojtësit të qendrës, Dardan Musliu. 19-vjeçari i lindur dhe i rritur në Gjermani, bashkohet me Llapin me kontratë 1-vjeçare me mundësi të vazhdimit edhe për një-vit tjetër. Musliu vjen në klubin tonë nga klubi gjerman, FV Lorrach-Brombach. Klubi është duke punuar intensivisht në krijimin e ekipit U-21 për edicionin e ri dhe Musliu përveç ekipit senior do mund të aktivizohet edhe në atë U-21", thuhet në njoftimin e skuadrës së Llapit.

Ancelotti: Nuk largohem nga Reali vetëm nëse më shkarkojnë

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka hedhur poshtë spekulimet që e lidhnin atë me Brazilin, duke thënë se nuk do të largohet derisa të shkarkohet. Italiani është lidhur me postin e "Selecaos" në javët e fundit, teksa Brazili kërkon një zëvendësues për Tite. Por, ai nuk po planifikon të largohet nga Real Madridi, ku ka një kontratë deri në vitin 2024. "Unë nuk do të largohem nga këtu derisa të më shkarkojnë. Jam i kënaqur që jam pjesë e historisë së Real Madridit. Kemi kaluar një kohë të mirë këtu në Marok, me shumë tifozë të Real Madridit që na mbështetin. Ne largohemi shumë të lumtur", ka thënë Ancelotti.

Leeds nis bisedimet me Gerrardin

Trajneri Steven Gerrard mund të bëhet me punë të re vetëm disa javë pas largimit nga Aston Villa. Ish-mesfushori legjendar anglez është në listën e dëshirave të Leeds Unitedit, skuadër që vazhdon të mbetet pa trajner pas shkarkimit të Jesse Marsch. Emri i ish-mesfushorit është edhe në listën e dëshirave të skuadrës tjetër angleze Southampton, por Leeds duket opsion më i pëlqyer për ish-trajnerin e Aston Villës dhe Rangersit. "Daily Express" ka raportuar se kjo javë pritet të jetë vendimtare për të ardhmen e Gerrardit nëse do ta pranojë ofertën e Leedsit apo atë të Southamptonit.

Guardiola: Besoj se Haalandi do të jetë gati ndaj Arsenalit

Erling Haaland luajti vetëm një pjesë të lojës ndaj Aston Villës dhe më pas u zëvendësua nga trajneri Pep Guardiola. Trajneri spanjoll ka thënë se ai pësoi një

lëndim, por se beson që do të jetë i gatshëm për derbin ndaj Arsenalit. "Haaland pësoi një goditje dhe nuk doja të rrezikoj, pasi po fitonim 3-0

dhe e zëvendësova. Ai luajti një pjesë loje dhe bëri një paraqitje të mirë. Tani do të monitorojmë gjendjen e tij dhe të shohim, pasi përpara kemi

një ndeshje të vështirë ndaj Arsenalit. Unë besoj se ai do të jetë gati për ndeshjen ndaj Arsenalit, por të shohim. Nuk kemi shumë lojtarë në

dispozicion në këto momente dhe dëmtimet kanë qenë të shumta. E rëndësishme është të mos pësojmë dëmtime të tjera", ka deklaruar Guardiola.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Mars Food" – SH.P.K, me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811370436 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa "Mars Food" - d.o.o., iz Prizrena donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811370436 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "Mars Food" - L.L.C, in Prizren has taken the decision to quit its business with NUI: 811370436, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Pipina" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810847527.

- Sheqer Kamberi shpall të pavlefshme dëftesat vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- Edmond Jahjaga shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB-Prishtinë, të lëshuar në vitin 2006.

- Zana Haraqija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Dardane Qela nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Armira Arifi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12,13 dhe diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari"

- Jonida Lulzim Haxhiajdini nga Peja shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të edukimit pran universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me nr. 408

- Liki&Abi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811477589.

- Shahin Arifi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT : Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).

- Blerta Gjeloshi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni"

- Lutfi Hajra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani" (ish Boris Kidric).

- Xhevdet Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha".

- Mentor Bunjkau B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:81036429.

- Famous Club sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810110114.

- Arbnor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e maturës te SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Berat Bajraktari shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Shefki Azemi shpalle te pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DTC me numër 366/18 Kursi Hidroinstalim-ujësjellës.

- Rafet Durmishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT" Arkitekt Sinani".

- Naser Hasani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e TVSH-se e numër 330043737.

- Mentor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM" Dr Xheladin Deda".

- Antigone Beka shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme " Dr. Xheladin Deda".

- Vëllezërit Hysa SH.P.K. Dega Kosove shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811324409.

- Sh.P.K Broja Market shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810359209.

- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.

- Granit Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Ora Travel SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811467168.

- Gabriell Prenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjiminazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Nora Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl I te sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Jozef Tunprenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Don Shtjefen Kurti" Novosell e Epërme nga kl.I-V dhe VI-IX

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues